# DËSHMI ARKIVI

**A-478382**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ngjarja tragjike/ Goditi kokën gjatë ndeshjes së futbollit, ndërron jetë 16-vjeçari shqiptar në Greqi |
| ADRESA | `https://tpz.al/ngjarja-tragjike-goditi-koken-gjate-ndeshjes-se-futbollit-nderron-jete-16-vjecari-shqiptar-ne-greqi-i334121` |
| BURIMI | tpz.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 29 shtator 2026, 08:43:09 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 29 shtator 2026, 08:30:41 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3e238c879fb7fcaa87a839a3e74473bae3628a1a5f1f731865f878146d752069` |
| TEKSTI | `80ab1d104098592056ae97f8a97410d14994dea700f4ca2ecb0ef735a5afcf23` |
| PAMJA | `382dd4a5147c708a880bea12af49e3ab5eeade6c416def7d20fd3b8fa364083c` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `48f8ca149c85b6705087bb0bd9a347015e3df1e10267262edb94e7bc007e914f` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `5542c6f376d7530e05241a95b291e64e02f5f89d799222f37a26423635f8fe31` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/48f8ca149c85b6705087bb0bd9a347015e3df1e10267262edb94e7bc007e914f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET, 29 SEPTEMBER 2026, 10:30

# Ngjarja tragjike/ Goditi kokën gjatë ndeshjes së futbollit, ndërron jetë 16-vjeçari shqiptar në Greqi

TPZ



Një ngjarje tragjike ka tronditur futbollin në Kavala të Greqisë, pasi një futbollist 16-vjeçar, me origjinë shqiptare, ka humbur jetën pas një dëmtimi të rëndë në kokë gjatë një ndeshjeje në ishullin Thassos.

Asllan Gjana, pjesë e skuadrës Byronas Kavala, po luante kundër Aiandas Panagias në një ndeshje të kategorisë së dytë të Shoqatës së Futbollit të Kavalës, kur vetëm në minutën e dytë të takimit u përplas rëndë. Gjatë një dyluftimi për topin, 16-vjeçari doli jashtë fushës dhe goditi pjesën e pasme të kokës në gardhin rrethues të stadiumit.

Pas përplasjes, ai humbi ndjenjat. Ndeshja u ndërpre menjëherë dhe futbollistit iu dha ndihma e parë nga mjeku i takimit. Në vendngjarje u thirr edhe shërbimi i urgjencës mjekësore, ndërsa për shkak të gjendjes së rëndë u vendos transportimi i menjëhershëm drejt spitalit.

16-vjeçari u dërgua në Spitalin e Kavalës, ku u shtrua në repartin e kujdesit intensiv. Pavarësisht përpjekjeve të mjekëve, ai nuk arriti të mbijetojë. Lajmi ka shkaktuar dhimbje të madhe te familja, shokët e skuadrës dhe komuniteti sportiv në Kavala.

Klubi Byronas Kavala reagoi me një mesazh prekës për ndarjen nga jeta të futbollistit të tij. "Me dhimbje të padurueshme dhe trishtim të papërshkrueshëm, familja atletike e Byron Kavalës i jep lamtumirën njërit prej fëmijëve të saj", thuhet në reagimin e klubit. "Byroni i Kavalës është në zi, ka humbur një nga fëmijët e tij. Udhëtim të mbarë, djali ynë, ti do të jetosh përgjithmonë në zemrat tona", vijon mesazhi.

ide!

Ish-shefja e SHISH, nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiqtë e saj
Nga Lorenc Vangjeli

Rikthimi i SHISH-it në politikë si banalitet
Nga Mero Baze

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose kliko këtu për mënyra të tjera kontakti.

Messenger

Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

Shiko të tjera video

AKTUALITET / 29 September 2026, 10:23

Hetimet/ Shpërthimi që shkaktoi 6 viktima në Athinë, çifti shqiptar në pritje të fëmijës, autoritetet dyshojnë për rrjedhje gazi

AKTUALITET / 29 September 2026, 10:18

Integrimi/ Ursula von der Leyen nis nesër turin ballkanik, ndalesa e parë Tirana! Presidentja e KE sjell planin e anëtarësimit për 4 shtete

AKTUALITET / 29 September 2026, 10:12

I dënuar me burg për vrasje, arrestohet në Itali 28-vjeçari! Pritet ekstradimi drejt Shqipërisë

AKTUALITET / 29 September 2026, 09:46

Projektbuxheti/ Nga taksat te pagat, paketa fiskale 2027 në tavolinë, biznesi hap listën e kërkesave

AKTUALITET / 29 September 2026, 09:40

VIDEO/ Me makinë mbi trotuar duke bërë filmime për TikTok, 60 mijë lekë gjobë shoferit në Berat! I hiqet leja e qarkullimit

AKTUALITET / 29 September 2026, 09:30

Operacioni/ U kap duke shitur kokainë në një lokal me qira, arrestohet 57-vjeçari në Maliq

AKTUALITET / 29 September 2026, 09:21

Seanca/ Kërkesa e PD për ligjshmërinë e Shabanit si Avokat i Popullit, sot shqyrtimi në Kushtetuese

AKTUALITET / 29 September 2026, 09:12

'Sekretet'/ Arrestimi i ish-drejtoreshës së SHISH, Manjani: Nuk kanë faj institucionet që Vlora Hyseni

u dashurua me dikë

AKTUALITET / 29 September 2026, 09:05

Rama në Samitin e Turizmit në Bruksel, Shqipëria në vëmendjen europiane

AKTUALITET / 28 September 2026, 22:20

Dështon tentativa e hyrjes së 10 shqiptarëve në Angli, po transportoheshin me një gomone me motorë të fuqishëm!

AKTUALITET / 28 September 2026, 21:55

"Auditim në SHISH pas arrestit të Vlora Hysenit", zbardhen diskutimet e kreut të SPAK dhe Ramës në Këshillin e Sigurisë

AKTUALITET / 28 September 2026, 21:34

Zjarr pranë banesave në lagjen "Zinxhira" në Gjirokastër

AKTUALITET / 28 September 2026, 19:57

Vihet nën kontroll zjarri në Kreshpan të Fierit, shoqërohen në komisariat tre persona

AKTUALITET / 28 September 2026, 19:51

Shpërthimi i automjetit në Elbasan/ Pronarja është drejtoresha e Shërbimit Social të Bashkisë, policia në vendngjarje, hetohen pistat

AKTUALITET / 28 September 2026, 19:26

Dita e 121-të e protestës,

AKTUALITET / 28 September 2026, 19:20

Spiropali takim me Raporterin

qytetarët marshojnë drejt Kryeministrisë

për Shqipërinë në Parlamentin Europian: Europa nuk është vetëm destinacioni ynë

AKTUALITET / 28 September 2026, 18:47

## Elbasan/ Makina përfshihet nga flakët në qendër të qytetit, qytetarët largohen me vrap (VIDEO)

AKTUALITET / 28 September 2026, 18:27

## Zjarr në Karicë të Matit, flakët përhapen nga livadhi drejt pyllit me dushqe, zjarrfikësit në terren

AKTUALITET / 28 September 2026, 17:52

## Zjarr i madh në Kreshpan të Fierit, flakët përhapen në ullishte e vreshta, kërkohet ndërhyrje nga ajri

AKTUALITET / 28 September 2026, 17:43

## Shpërthimi vdekjeprurës në Athinë ku humbën jetën edhe tre shqiptarë, zbardhen detaje të reja nga hetimi



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.